



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

Pranuar - Primeshje Nr. 28-02-2014

Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vendosje
01	013/268		

Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gazetës Zyrtare nr. 28/2008 dhe nenit 36.2 shkronja d) së Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr. 013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më 26.02.2014, aprovon këtë:

## V E N D I M

**për caktimin e lokacionit për ndërtimin e shtatores së Rashit Mustafës –Komandant Karadaku, në parcelën kadastrale nr.2496-3 të Zonës Kadastrale - Viti**

### Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë, CAKTON lokacion për ngritjen e shtatores së Rashit Mustafës - komandant karadaku nga Lubishta i rënë në luftën e fundit për çlirimin e Kosovës.

### Neni 2

Vendi për ngritjen e shtatores nga neni 1 i këtij vendimi caktohet në Zonën Kadastrale - Viti, i cila gjendet te stacioni i autobusëve në pjesën perëndimore të rrugës Viti - Kllokot në parcelën kadastrale nr.2496-3, në pronësi të Komunës së Vitisë dhe ka një sipërfaqe prej 237m<sup>2</sup> me dimensione të ofruara nga Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë.

### Neni 3

Ky Vendim është miratuar nga Kuvendi i Komunës në bazë të propozimit të Drejtorisë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi dhe kërkesës së Këshillit Organizativ për ngritjen e shtatores së Rashit Mustafës – Komandant Karadaku.

### Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Vitisë.

### Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. DKPGJ-së,
2. DKRS-së, dhe
3. Arkivit

Kryesuesi i Kuvendit:  
Naim Pira

